

Nr. Ref: 12/ZDP/VE/2023
29.12.2023

Në mbështetje të neneve 2, 14.2, 35, 36 të Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), Marrëveshjes bilaterale për transportin ajror në mes Zvicrës dhe Kosovës,

Duke vepruar në përgjigje të kërkesave të pranura në AAC nga operatorët ajror me Certifikatë të Operatorit Ajror (COA) të Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Zvicrës (Konfederata Helvetike),

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (më tutje "AAC") nxjerr këtë:

VENDIM

- Lejohet zhvillimi i ushtrimit të veprimtarisë së transportit ajror për fluturimet me orar të caktuar dhe pa orar të caktuar, të pasagjerëve, ngarkesave dhe/ose postës, për dhe nga Kosova në shtetet e HPEA, për:
 - operatorët ajror me Certifikatë të Operatorit Ajror (COA) të Republikës së Shqipërisë, si shtet pjesëmarrës i Marrëveshjes Multilaterale HPEA dhe poashtu interesit ekonomik dhe gjeostrategjik ndërshtetëror, si dhe
 - për operatorët ajror me Certifikatë të Operatorit Ajror (COA) të Shtetit të Zvicrës (Konfederata Helvetike), si shtet me të cilin Kosova ka marrëveshje bilaterale dhe poashtu interesit ekonomik dhe gjeostrategjik ndërshtetëror.
- Operatorët ajror nga pika 1 e këtij Vendimi, mund të marrin aprovimin e orarit të fluturimit për destinacionet e kërkuara, vetëm pasi të dëshmojnë në AAC se kanë aprovim nga organi kompetent në shtetin e destinacionit, për fluturimet e planifikuara.
- Ky Vendim hynë në fuqi më 01.01.2024 dhe është i vlefshëm deri më 31.12.2024.

Arsyetim


Duke marrë parasysh interesin publik të vendit, tani kur Kosova ndodhet në një udhëkryq me një mundësi për ta shfrytëzuar potencialin ekonomik sipas parimit të liberalizimit të fluturimeve dhe udhëtimeve ajrore, e posaçërisht tani kur nga 1 Janar 2024 hyn në fuqi heqja e regjimit të vizave për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe kërkesa për udhëtime është rritur shumë.

Në mungesë të një kompanie ajrore kombëtare, Kosova deri më tani ka vuajtur nga çmimet e larta të biletave, rritja e konkurrencës midis linjave ajrore çon në çmime më konkurruese dhe një gamë më të gjerë udhëtimesh dhe opsioneve për konsumatorët.

Poashtu, duke respektuar parimin e lëvizjes së pakufizuar, kufizohet mundësia e monopolit të tregut nga operatorët ajror, e poashtu krijohen mundësi shtesë për të investuar në Kosovë me përfitime edhe ekonomike por edhe në aspektin social. Kjo jo vetëm që është një përfitim për qytetarët dhe mërgatën Kosovare por e bën Kosovën edhe destinacion më tërheqës për vizitorët ndërkombëtarë.

Liberalizimi i fluturimeve dhe shtimi i linjave ajrore shërben si një katalizator i fuqishëm për rritjen ekonomike, duke nxitur rritjen e turizmit, tregtisë, dhe aktivitetet e biznesit, mundësinë për të investuar në Kosovë dhe për të punësuar edhe personel vendor siguron përfitime ekonomike që do të shpërndahen brenda vendit.

Duke marrë parasysh nenet 14.2, 35, 36 të Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), Marrëveshjes bilaterale për transportin ajror në mes Zvicrës dhe Kosovës, dhe interesin publik në shtimin e linjave ajrore me çmime konkurrencte, drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Alban Ramabaja
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Vendimi i dërgohet:

- Ministrit të MMPHI;
- Sekretarit të MMPHI; dhe
- Arkivit të AAC-së.